



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 18/23

29/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje prej: Vedat Poterqoi- Kryetar, Kimete Gashi- Anëtare dhe Agon Ramadani- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Botek" sh.p.k me numër të protokollit 18/23, dhe ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Future BITS" shp.k me numër protokollit 29/23, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me tabela të mençura" me nr. të prokurimit: 616-22-14100-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datën 27.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- Aprovohen**, si të bazuara ankesat e operatorit ekonomik "Botek" sh.p.k me numër të protokollit 18/23, dhe ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Future BITS" shp.k me numër protokollit 29/23, për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me tabela të mençura" me nr. të prokurimit: 616-22-14100-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
- Obligohet**, Autoriteti Kontraktues që ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosjen e tenderit konform nenit 53 pika 7 të LPP-së si dhe nenit 24, në mënyrë që dosja e tenderit të jetë në harmoni me nenin 27 të këtij ligji, si dhe ti japë qasje OE të interesuar për aktivitetin e sipër cituar të prokurimit
- Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me

Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

4. Meqenëse ankesat aprovohen si të bazuara, ju bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 09.12.2022, AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë (dosja e tenderit) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me tabela të mençura” me nr. të prokurimit: 616-22-14100-1-1-1. Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve 08. 01. 2023.

OE “Botek” me datën 23. 12. 2022 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim. AK i ka kthyer përgjigje me datën 29. 12. 2022.

Me datën 23. 12. 2022 OE “Future Bits” ka dorëzuar në AK kërkesën për rishqyrtim. AK është përgjigjur me datën 29. 12. 2022.

Në sistemin e e-prokurimit, me datën 06 janar 2023 OSHP ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik “Botek” shpk me nr. 18/23 (numër protokolli).

Në sistemin e e-prokurimit, me datën 10 janar 2023 OSHP ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik “Future Bits” shpk me nr. 29/23 (numër protokolli).

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesat në rastin konkret, janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 19.01.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesat e OE-ve ankues të aprovohen si pjesërisht të bazuara,
- të bëhen korrigjimet në dosjen e tenderit dhe qasja e OE

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në pretendimet e OE ankues "Botek"

Në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë janë kërkuar këto kritere ku janë edhe pretendimet ankimore të OE ANKUES

Përgjigje në Pretendimi nr.1 "BOTEK SH.P.K."

Sa i përket pretendimit ankimor se ky kriter është diskriminues ku është kërkuar 4. OE duhet të paraqes se produkti duhet të posedoj certifikatën e kualitetit për shpenzim minimal të energjisë nga një qendër e akredituar.

4. Kopja e certifikatës e noterizuar për vitin 2022

Eksperti shqyrtues vlerëson që ky pretendim ankimor është i bazuar pasi që për këtë produkt mund të kërkohej certifikatat e tilla të cilat mund të verifikohen në websiten e tyre. Pajisjet e kërkuara në këtë aktivitet të prokurimit janë të vendeve të ndryshme dhe është e pa mundur që të noterizohet nga OE të cilët operojnë në Republikën e Kosovës. Andaj si ekspert shqyrtues vlerësojnë që ky kriter duke kërkuar që certifikata të jetë e noterizuar duhet të korrigjohet pra mjafton si e tillë pasi që mund të verifikohet shumë lehtë.

Përgjigje në Pretendimi nr.2 "BOTEK SH.P.K."

Sa i përket pretendimit ankimor Prodhuesi OE duhet të paraqes dëshmitë e nevojshme që produkti ka kaluar testet kundër zjarrit. 6. Kopja e certifikatës e noterizuar për vitin 2022. Ky pretendim ankimor i përfshirë në ankese nuk qëndron pasi që Autoriteti Kontraktues më 06.01.2023 e ka larguar si kriter të dosjes së tenderit duke e korrigjuar edhe dosjes e tenderit pra më 06.01.2023.

Përgjigje në Pretendimi nr.3 "BOTEK SH.P.K."

Sa i përket pretendimit ankimor se është shkel neni 53 i LPP-së-Sigurimi i Informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit si ekspert shqyrtues vlerësoj që çdo AK është i obliguar të ju përgjigjet OE lidhur me kërkesat për sqarime. OE Botek sh.p.k. pretendon që AK nuk ju ka përgjigje në kërkesën e tyre për sqarime.

OE Botek sh.p.k. brenda afatit ligjor ka bërë pyetje lidhur me kapacitetit teknik dhe profesional:

3. OE apo prodhuesi duhet te jetë e licencuar me standardet si në vijim a) ISO 9001 2015; b) Certifikatën c) ISO 14001, ISO 54001 d) Prodhuessi duhet te paraqes certifikatat e CE, FCC dhe ROHS për eksport ne Evrope.

3. Kopja e licencave dhe certifikatave me validitet për vitin 2022.

Me këtë rast ka kërkuar sqarim për certifikatën ISO 54001 e që duhet të jetë 45001. Ky pretendim nuk qëndron pasi që AK ju ka përgjigje 21.12.2022 ku thekson që:

AK konfirmon se është bërë një lëshim teknik dhe fjala është për ISO 45001

Pastaj Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës:

në muaj ose në ditë 45 ose

fillim përfundim

kushtet e veçanta

Dorëzimi 21.3 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës

Ky pretendim ankimor është i bazuar pasi që OE nuk ka marrë përgjigje dhe AK është i obliguar që të ju përgjigjet OE në të gjitha pyetjet.

Kërkesa 3 e OE Botek dërguar AK-së

Në FDT kërkohet Garancioni 1 vit, kushtet e veçanta

Obligimet e garancionit	24.1	3 vite garancion
-------------------------	------	------------------

Ju lutem sa duhet të jetë kohëzgjatja e garancionit për paisjet e kërkuara.

Eksperti shqyrtues vlerëson që ky pretendim ankimor është i bazuar pasi që në dosje të tenderit tek specifikimet teknike garancioni i këtyre paisjeve është 1 vit ndërsa te kushtet e veçanta ky garancion kërkohet 3 vite e që është në shpërputhje njëra me tjetrën. Andaj AK nuk ka kthyer përgjigje në këtë pyetje sqaruesi.

Kërkesa e 4 e OE Botek sh.p.k.

Dokumenti-Përshkrimi i çmimit

Pyetja: Meqenëse te dokumenti "Përshkrimi i çmimit" në përshkrimin e produkti është bartje specifikimi i dosjes së kaluar të tenderit: Coax in dhe Coax aut, kërkojmë nga ju që ky dokument i përshkrimi të çmimit të ringarkohet në versionin e ri në sistem në mënyrë që specifikimet në të te jenë të njëjta me dosjes e tenderit ANEKS 1.

Te ky pretendim ankimor AK është dashur ti kthej përgjigje OE, mirëpo është përgjegjësi dhe kompetencë e AK-së se çfarë versioni të përshkrimit të çmimit ta ngarkoj në sistem . Pra ky pretendim ankimor është i pa bazuar pasi që me 06.01.2023 është ngarkuar dosja e re dhe specifikimet teknike përputhen në tërësi me përshkrimin e çmimeve.

Kërkesa e 5 e OE Botek sh.p.k.

Kapaciteti teknik dhe profesional

3. OE apo prodhuesi duhet të jetë e licencuar me standardet si në vijim a) ISO 9001 2015; b) Certifikatën c) ISO 14001, ISO 54001 d) Prodhuesi duhet të paraqes certifikatat e CE, FCC dhe ROHS për eksport ne Evrope.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

3. Kopja e licencave dhe certifikatave me validitet për vitin 2022.

Kërkesë:

Sqarim: Për prodhuesit amerikan, të cilët duan që produktet e tyre t'i shesin në tregun evropian, ata duhet të pajisen me certifikatë CE. Për të përfituar këtë certifikatë, prodhuesi fillimisht duhet të ketë kaluar testimet për FCC.

Rrjedhimisht, prodhuesi i pajisur me CE ka kaluar këto teste. Për vërtetimin e kësaj janë raportet e testeve (test report) të cilat janë mëse të mjaftueshme për të vërtetuar testimin e produktit për FCC.

Andaj, kërkojmë nga ju që të ndryshohet kjo kërkesë dhe si dokument ekuivalent për certifikatën FCC, të pranohet edhe dokumenti: Test report. Apo edhe të largohet kërkesa për FCC pasi që certifikata FCC është certifikim për shitje të produkteve në SHBA, mirëpo gjithnjë duke dorëzuar certifikate CE e cila është kërkesë valide për shitje në Evropë.

Sa i përket kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që paisjet të jenë të kualitetit të lart dhe dëshminë të cilën e ka kërkuar për këto certifikata është ligjore dhe në harmoni me specifikat e kërkuara. Andaj AK është dashtë që ti kthej përgjigje OE i cili ka bërë pyetje për këtë çështje edhe pse kërkesa e AK është e qartë. Ky pretendim ankimor është i bazuar vetëm për faktin që AK-ja nuk ka kthyer përgjigje në pyetjen e parashtruar nga OE.

Kërkesa e 6 e OE Botek sh.p.k. Kapaciteti teknik dhe profesional

4. OE duhet të paraqes se produkti duhet të posedoj certifikaten e kualitetit per shpenzim minimal te energjise nga nje qender e akredituar.

4. Kopja e certefikates e noterizuar për vitin 2022

6. Prodhuesi OE duhet të paraqes deshmite e

nevojshme qe produkti ka kaluar testet kunder

zjarrit.

6. Kopja e certifikates e noterizuar për vitin

2022

7. Prodhuesi OE duhet te paraqes deshmi se

produkti ka kaluar testin e ndryshkjes korrizonit

7. Kopja e certifikates e noterizuar për vitin

2022

Si të tilla, ato nuk mund të noterizohen, pasi që sipas Ligjit të Noterisë në Kosovë Nr. 06/L-010, Neni 47- Vërtetimi i kopjeve të dokumenteve origjinale, në asnjë rrethanë nuk lejohet noterizimi i kopjeve të dokumenteve (në këtë rast certifikatave).

Duke marrë parasysh se qëllimi i noterizimit të dokumenteve është vërtetimi i vlefshmërisë së tyre, kjo kërkesë nuk është e arsyeshme, pasi që vlefshmëria certifikatave të kërkuara, mund të vërtetohet përmes nr të certifikatës, tek web faqja e trupit certifikues, i cili ka lëshuar ato.

Rrjedhimisht, kjo kërkesë e juaja po kufizon konkurrencën, duke favorizuar OE të caktuar. Kjo paraqet shkelje të LPP-së, neni 7 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi.

Prandaj, kërkojmë nga ju si AK, që të largoni këtë kërkesë nga FDT për dokumente të noterizuara, duke lejuar që më shumë OE të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në këtë aktivitet të prokurimit.

Sa i për këtë këtij pretendimi ankimor për piken 4 e kemi sqaruar në fillim ndërsa piken 6 dhe 7 AK-ja i ka larguar nga dosja e tenderit duke e ngarkuar dosjen e re në e-prokurim më 06.01.2023 andaj ky pretendim është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.1 Future BITS sh.p.k.

1. Sqarime Shtese me datë 19.12.2022, ku pas pranimit te vendimit te AK-se te datës 22.12.2022 ndaj sqarimeve shtese nuk pajtohem me përgjigjet e autoritetit, derisa AK ne disa pyetje shume te rëndësishme për këtë aktivitet qe i kemi parashtruar nuk na ofroj përgjigje fare.

Ky pretendim ankimor është i bazuar pasi që AK-ja nuk ka dhënë përgjigje në të gjitha pyetjet e OE të cilët kanë kërkuar sqarime.

Përgjigje në Pretendimi nr.2 “ Future BITS sh.p.k

2. Kërkesën për Rishqyrtim me datë 23.12.2022, ku kemi kërkuar te largohen kriteret diskriminuese ne FDT te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2 me numrat rendor 4,5,6,7 dhe kërkesat e tjera për specififikimet teknike dhe cilit specifikim duhet ti përmbahemi.

Autoriteti Kontraktues vendos qe te largoj nga formulari i dosjes se tenderit ne piken 9.1. dhe 9.2., kriterin me nr.6, 7 dhe 10.

Ky pretendim ankimor është i bazuar pasi që në Vendimin e Kërkesës për Rishqyrtim pra largon kriterin nr.6,7 dhe 10 e që është e drejt e AK-së se cilat kriteret ti vendos në dosje të tenderit mirëpo konform Kërkesës për Rishqyrtim AK-ja është dashtë të kthej përgjigje për të gjitha pretendimet ankimore dhe në të gjitha pyetjet e parashtruara nga OE.

Përgjigje në Pretendimi nr.3 “ Future BITS sh.p.k

AK, nuk na është përgjigjur fare rreth pyetjeve te specifikimit teknik dhe pavarësisht operatoreve ekonomik AK nuk mundet ne asnjë rrethane te vazhdoj këtë aktivitet derisa te rregulloj kriteret e brendshme te aktivitetit, sepse autoriteti kontraktues ka 2 specifikime teknike për te njëjtin aktivitet, e qe është ne kundërshtim me LPP-ne, e për këtë edhe kemi bere pyetje ne sqarime shtese dhe kërkesë për rishqyrtim mirëpo jemi pa përgjigje. Ne kërkojmë prape te na sqarohet se cilit specifikim duhet ti përmbahen operatorët sepse ka dy specifikime ne E-prokurim për te njëjtin aktivitet: a) Specifikacion-tabelat interactive dhe b) Përshkrimi i çmimeve, Prandaj kërkojmë qe Organi Shqyrtues i Prokurimit te shtjelloj se cilit specifikim duhet ti përmbahemi a) apo b), pasiqe është kushti kryesor dhe i vetëm ne baze te cilit do te behet evolimi si dhe vërtetimi i përgjegjshmërisë se ofertuesve, AK për këtë kërkesë duhej te na ofronte përgjigje.

Edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar pasi që AK-ja e ka korrigjuar dosjen e tenderit më 06.01.2023 ora 13:43 dhe të ngritur në sistemin e e-prokurimit dhe ku përshkrimi i çmimeve përputhet në tërësi me specifikimet teknike të dosjes së tenderit.

Përgjigje në Pretendimi nr.4 “ Future BITS sh.p.k

KERKESA 1:

Ne FDT te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 dhe 9.2 pretendojmë se janë bere kërkesa te cilat janë totalisht te paqarta dhe diskriminuese, pra kriteret e mbetura (certifikatat) Nr.4 dhe 5, te cilat duhet larguar nga FDT dhe te na mundësohet pjesëmarrja me kriteret e drejta, te barabarta e jo diskriminuese.

Kriteri Nr.4, tek FDT pika 9.1&9.2:

Ne këtë kriter te vendosur ne DT, AK ka kërkuar qe produkti i ofruar te posedoj certifikatën e kualitetit për shpenzim minimal te energjisë nga një qendër e akredituar dhe kjo duhet te vërtetohet me kopje te noterizuar për vitin 2022.

Kjo kërkesë e AK-se, fillimisht është plotësisht e paqarte se nuk ka KERKESA 1:

Ne FDT te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 dhe 9.2 pretendojmë se janë bere kërkesa te cilat janë totalisht te paqarta dhe diskriminuese, pra kriteret e mbetura (certifikatat) Nr.4 dhe 5, te cilat duhet larguar nga FDT dhe te na mundësohet pjesëmarrja me kriteret e drejta, te barabarta e jo diskriminuese.

Kriteri Nr.4, tek FDT pika 9.1&9.2:

Ne këtë kriter te vendosur ne DT, AK ka kërkuar qe produkti i ofruar te posedoj certifikatën e kualitetit për shpenzim minimal te energjisë nga një qendër e akredituar dhe kjo duhet te vërtetohet me kopje te noterizuar për vitin 2022.

Kjo kërkesë e AK-se, fillimisht është plotësisht e paqarte se nuk ka vlera të përcaktuara saktësisht në baze të cilave do të mund të bëhet vlerësimi i drejtë dhe i paanshëm i ofertave të dorëzuara nga OE. Kërkesa është e panevojshme për faktin se AK në specifikimet teknike të produktit ka definuar shumë qarte vlerat e energjisë: “Energjia elektrike 100-240V, 50-60Hz”.

Derisa me kërkesën për noterizim e rëndon edhe me tepër procesin, sepse po kërkon dokumente që nuk mund të dorëzohen nga operatorët.

Ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar pasi që kjo kërkesë mjafton të jetë certifikatë e cila nuk duhet kërkuar e noterizuar pasi që shumë lehtë mund të verifikohet në veb site të paisjeve. Pra mjafton kjo certifikata e cila nuk duhet të kërkohej e noterizuar (ky pretendim ankimor për këtë certifikata e kamë sqaruar edhe te OE Botek sh.p.k.).

Përgjigje në Pretendimi nr.5 “ Future BITS sh.p.k.

Kriteri Nr.5, tek FDT pika 9.1&9.2: Në këtë kriter të vendosur në DT, AK ka kërkuar dëshmi se produkti posedon teknologjinë e fundit për mos dëmtimin e syrit të lexuesit dhe kjo duhet të përcillet me kopje të certifikatës valide IEC EN62471 apo nga ndonjë institucion i akredituar, Prandaj, duke marrë parasysh se AK ka përcaktuar standardin që duhet të plotësojë ekrani i tabelës së mençur tek specifikat teknike: 4K UHD, (3840 × 2160), Direct led DLED, Xhami: kundër shkëlqimit, Shkëlqimi (maksimumi): ≥ 350 cd/m, AK prape me kërkesën për këtë certifikatë bën diskriminim dhe pamundëson pjesëmarrjen në ofertim.

Nga Organi Shqyrtues i Prokurimit kërkojmë që të largojmë këtë kriter i cili nuk po na mundëson që produktin ky pretendim ankimor si ekspert shqyrtues vlerësojnë që është i pa bazuar pasi që AK-ja ka interes që të furnizoj me paisje të teknologjisë me të mire. Shumica e këtyre paisjeve të teknologjisë me të re janë paisje të avansuar dhe të cilat nuk i dëmtojnë sytë e përdoruesve dhe lexuesve.

Përgjigje në Pretendimi nr.6 “ Future BITS sh.p.k.

Kërkesa 2:

1. Smartboard duhet të këtë lidhje interneti port: RJ45 (x2) 100 baseT.

Kërkojmë që të largohet njeri port dhe të mundësohet ofertimi i smartboard me të paktën 1 port RJ45. Për këtë kriter teknik nuk pranuar përgjigje as në kërkesë për Sqarime Shtese as në Kërkesë për Rishqyrtim.

Prandaj kërkojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit të shtjellojë kërkesën për Port RJ45 dhe të kemi një përgjigje të sakte dhe të qarte.

Te ky pretendim ankimor AK-ja është dashtë që të kthejë përgjigje, megjithatë AK ka kompetencën e saj që të vendos specifikimet teknike konform nevojave të saj dhe JO sipas dëshirave dhe kërkesave të OE. Andaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.7 “ Future BITS sh.p.k.

2. Te specifikat teknike minimale është edhe kërkesa: Gjuha e programit Shqip/Anglisht.

Ne kërkesën tone për Sqarime Shtese si dhe Kërkesën për Rishqyrtim, ne si OE nuk kemi marre përgjigje nga ana e AK-se fare as për këtë pike, ku kërkojmë një përgjigje te qarte rreth specifikut te gjuhës shqipe për tabelat e mençura sepse këto tabela do te përdoren ne Kosove nga profesorët dhe nxënësit e Kosovës.

Kërkesa teknike e kërkuar nga AK: Gjuha e programit: Shqip /Anglisht, kërkesa ku thuhet gjuha e programit është kërkesë e mangët dhe jo 100% e kuptueshme andaj për këtë kërkuam sqarime nga AK. Prandaj kërkojmë qe Organi Shqyrtues i prokurimit te shtjelloj këtë kërkesë për te cilën neve nuk na janë përgjigjur AK.

Te ky pretendim ankimor AK-ja është dashtë që të kthej përgjigje, megjithatë AK ka kompetencën e saj që të vendos specifikut teknike konform nevojave të saj dhe JO sipas dëshirave dhe kërkesave t OE. Andaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar pasi që kërkesa është e qartë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 19 janar 2023 me raportin e ekspertizës.

1. Autoriteti kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datën 19 janar 2023, ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së .

2. Operatori ekonomik ankues "Botek", me datën 20 janar 2023 ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

3. Operatori ekonomik ankues "Future Bits", me datën 23 janar 2023 ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas pranimi të raportit të ekspertit, dhe deklarimit të palëve lidhur me të, vlerësoj se seanca dëgjimore mund të mbahet pa prezencën e palëve sepse nga provat dhe shkresat e lëndës, mund të merret një vendim përfundimtar nga ana e panelit shqyrtues të OSHP-së, andaj konform nenit 24 par 1 i Rregullores së punës së OSHP-së, seanca dëgjimore u mbajt pa prezencën e palëve.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, sqaron se:

Pretendimet e OE ankues "Botek"

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues dhe kryesor të bërë edhe me Kërkesë për ri-shqyrtim të, se AK ka bërë shkelje të LPP-së dhe RRUOPP-së, pasi që për pesë (5) kërkesat e tjera, nuk ka kthyer asnjë përgjigje, refuzuese ose pranuese, sikurse kërkohet me LPP, Neni 53 i LPP Nr. 04/L-042 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit, paragrafi 5 dhe RRUOPP Pika 24 e RRUOPP Nr.001/2022 ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore, paragrafi 4, paragrafit 24.3, PSH këtë pretendim e klasifikon të bazuar për arsye se OE ankues nuk ka marrë të gjitha përgjigjet në kërkesën për informacione dhe sqarime shtesë të bërë në drejtim të AK, përveç përgjigjes përmes vendimin në kërkesën për ri-shqyrtim, ku është shumë e mangët dhe pa asnjë arsytim. Kjo paraqet shkeljeve të dispozitave nga ana e AK-së, duke përfshirë nenin 53, 108/A të LPP-së, si dhe nenit 24 të Rregullores Nr.001/2022 për prokurimin publik. Andaj, obligohet AK që gjatë fazës së zgjatjes së afatit për tenderim dhe përmirësimin të Dosjes së Tenderit të kthejë përgjigje për të gjitha informatat apo sqarimet e kërkuara nga të gjithë OE dhe ta rishikoj mospërputhshmërinë e pretenduar të OE ankues sa i përket Dosjes së Tenderit dhe përshkrimin të çmimeve.

Pretendimet e OE ankues "Future BITS"

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se Sqarime Shtese me datë 19.12.2022, ku pas pranimit të vendimit të AK-se të datës 22.12.2022 ndaj sqarimeve shtese nuk pajtohem me përgjigjet e autoritetit, derisa AK ne disa pyetje shume të rëndësishme për këtë aktivitet që i kemi parashtruar nuk na ofroj përgjigje fare. PSH këtë pretendim e klasifikon të bazuar për arsye se OE ankues nuk ka marrë të gjitha përgjigjet në kërkesën për informacione dhe sqarime shtesë të bërë në drejtim të AK, përveç përgjigjes përmes vendimin në kërkesën për ri-shqyrtim, ku është shumë e mangët dhe pa asnjë arsytim. Kjo paraqet shkeljeve të dispozitave nga ana e AK-së, duke përfshirë nenin 53, 108/A të LPP-së, si dhe nenit 24 të Rregullores Nr.001/2022 për prokurimin publik. Andaj, obligohet AK që gjatë fazës së zgjatjes së afatit për tenderim dhe përmirësimin të Dosjes së Tenderit të kthejë përgjigje për të gjitha informatat apo sqarimet e kërkuara nga të gjithë OE dhe ta rishikoj mospërputhshmërinë e pretenduar të OE ankues sa i përket Dosjes së Tenderit dhe përshkrimin të çmimeve.

Lidhur me pretendimin ankimor se ne FDT të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 dhe 9.2 pretendojmë se janë bere kërkesa te cilat janë totalisht te paqarta dhe diskriminuese, pra kriteret e mbetura (certifikatat) Nr.4 dhe 5, te cilat duhet larguar nga FDT dhe te na mundësohet pjesëmarrja me kriteret e drejta, te barabarta e jo diskriminuese. PSH pretendimin ankimor sa i përket kërkesës nr. 4 e klasifikon të bazuar duke u mbështetur në arsyetimin e dhënë nga ekspertit shqyrtues në raportin e tij të ekspertizës për këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa PSH lidhur me pretendimin ankimor për kërkesën nr. 5 ne këtë kriter të vendosur në DT, AK ka kërkuar dëshmi se produkti posedon teknologjinë e fundit për mos dëmtimin e syrit të lexuesit dhe kjo duhet të përcillet me kopje të certifikatës valide IEC EN62471 apo nga ndonjë institucion i akredituar, Prandaj, duke marrë parasysh se AK ka përcaktuar

standardin qe duhet te plotësojë ekrani i tabelës se mençur tek specifikat teknike: 4K UHD, (3840 x 2160), Direct led DLED, Xhami: kundër shkëlqimit, Shkëlqimi (maksimumi): > 350 CD/, Paneli shqyrtues e obligon autoritetin kontraktues që ta ri-shiqoj këtë kërkesë sepse AK në përgjigjen e tyre por edhe eksperti shqyrtues nuk kanë dhënë arsye bindëse të argumentuar se pse duhet të qëndroj kjo kërkesë, e cila si e tillë mundet me qenë diskriminuese.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se AK ka kërkuar qe produkti i ofruar te posedoj certifikatën e kualitetit për shpenzim minimal te energjisë nga një qendër e akredituar dhe kjo duhet te vërtetohet me kopje te noterizuar për vitin 2022. PSH këtë pretendim e klasifikon si pjesërisht të bazuar duke u mbështetur në arsyetimin e dhënë nga eksperti shqyrtues në raportin e tij të ekspertizës për këtë aktivitet të prokurimit.

Lidhur me pretendim ankimor të OE ankues sa i përket Kërkesa 2, 1.Smartboard duhet te ketë lidhje interneti port: RJ45 (x2) 100 baseT, edhe për këtë pretendim OE ankues nuk ka marrë përgjigje nga AK. Andaj, obligohet AK që të veproj konform dispozitave ligjore për kthimin të përgjigjeve dhe sqarimeve.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sa i përket se Te specifikat teknike minimale është edhe kërkesa: Gjuha e programit Shqip/Anglisht, edhe për këtë pretendim OE ankues nuk ka marrë përgjigje nga AK. Andaj, obligohet AK që të veproj konform dispozitave ligjore për kthimin të përgjigjeve dhe sqarimeve.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 27 dhe 53 të LPP dhe dispozita 24 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik, të cituara në Ankesë, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur me plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që të anulohet njoftimi për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit sepse, në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat POTERQOI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale, dhoma e shkallës së parë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK-së
- 1x1 OE "Botek"
- 1x1 OE "Future Bits"
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.